



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KORÇË**  
**KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

Vendim

Nr. 60 Datë 30-04-2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 139 DATË 26.12.2025 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR TË VITIT 2026 DHE PBA 2026-2028 TË BASHKISË KORÇË"**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe shkresës nr. prot. 454/39, datë 24.03.2026 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të projektit: "Zgjerimi i shërbimit mbështetës për fëmijën dhe familjen" për periudhën 2026-2029

**VENDOSI:**

1. Të miratojë 7 (shtatë) pozicione shtesë mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Korçë, duke e çuar numrin total të punonjësve nga 393 në 400 punonjës, sipas tabelës si më poshtë:

<b>Bashkia Korçë- Qendra për shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen përfitues</b>
2 Psikolog
4 Punonjës Social
1 Fizioterapist

2. Efektet financiare do të përballohen nga fondi social i miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2026.
3. Të miratojë 1 (një) pozicion shtesë mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve të Qendrës së Artit dhe Kulturës, duke e çuar numrin total të punonjësve nga 56 në 57 punonjës, sipas tabelës si më poshtë:

<b>Qendra e Artit dhe Kulturës</b>
Specialist i Galerisë së Artit Digjital

4. Efektet financiare do të përballohen nga fondi i Qendrës së Artit dhe Kulturës për vitin 2026
5. Marrëdhënia e punës me personat që do punësohen do të rregullohet sipas ligjit nr. 9761 datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
6. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK, Drejtoria e Kujdesit Social dhe Qendra e Artit dhe Kulturës.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Eva NAÇI**

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kundër 2

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 30-04-2026



**K R Y E T A R**

**Ana VERUSHI**